



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 2132/11 Prot.,

Tiranë, më 28/10 / 2025

Lënda: Dërgohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Portual Durrës

Të gjitha Departamenteve

Të gjitha Drejtorive në DPD

Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm

Të gjitha Degëve Doganore

Ju bëjmë me dije se është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit Nr. 2132 Prot., datë 24.10. 2025 ndërmjet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Portual Durrës "Për shkëmbimin e të dhënave të informacionit paraprak për ngarkesat detare si në hyrje (para-mbërritjes) dhe në dalje (para-nisjes)".

Merrni masat për njohje dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Strukturat teknike kompetente, të marrin masat për zbatimin e detyrimeve sipas përcaktimeve në marrëveshje.

Duke Ju falenderuar,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PORTUAL Durrës

Nr. 21932 Prot., datë 24.10.2025.

Nr. 3870 Prot., datë 22.10.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DHE
AUTORITETIT PORTUAL Durrës
PËR

SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE TË INFORMACIONIT PARAPRAK PËR NGARKESAT
DETARE SI NË HYRJE (PARA-MBËRRITJES) DHE NË DALJE (PARA-NISJES)

“Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”, person juridik, pajisur me NIPT J72122006U, me seli në adresën: Rr. Industriale Tiranë-Durrës, Km. 1, kati 5, Qendra Pajton, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga z. Genti GAZHELI, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave,

dhe

“Autoriteti Portual Durrës”, person juridik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual” si dhe - VKM Nr. 282, datë 8.05.2024 “Për miratimin e statutit të APD”, pajisur me NIPT J61811536L, me seli në adresën: Lagja nr. 1, Rr. “Tregtare” Durrës, përfaqësuar nga z. Kreshnik Bajraktari, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv,

Referuar më poshtë si “Palët”, bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkepunimi, me kushtet dhe termat si më poshtë vijon:

Neni 1
Baza Ligjore

Kjo marrëveshje lidhet bazuar në ligjin nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr.9130, datë 8.09.2003 “Për Autoritetin Portual”; Vendimin e

Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 8.05.2024 “Për miratimin e statutit të APD”; ligjin nr.124, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Neni 2

Objekti

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcakton kushtet për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit Portual Durrës, në integrimin dhe përdorimin e platformës ASYHUB.

ASYHUB është një platformë e standardizuar komunikimi dhe përpunimi për integrimin e të dhënave, e cila përmes lidhjes me një platformë të dhënash tregtare dhe transporti të bazuar në DLT, siç është TradeLens, shërben si një kanal alternativ por më i sofistikuar për dorëzimin e informacionit paraprak të ngarkesës (sistem-me-sistem).

Neni 3

Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim sigurimin e shkëmbimit dixhital të të dhënave midis sistemeve TIK të ofruesit të të dhënave të anijes (Autoriteti Portual Durrës) dhe sistemit ASYCUDA World në Administratën Doganore Shqiptare, me qëllim përpunimin e informacionit të para-mbërritjes dhe para-nisjes të ngarkesave detare.
2. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti lidhet me:
 - a. Thjeshtimin dhe automatizimin e procesit të dorëzimit të informacionit të manifestit të ngarkesës detare nëpërmjet platformës ASYHUB, për të harmonizuar dhe përmirësuar informacionin që i jepet autoritetit doganor, duke i ofruar këtij autoriteti informacion më të pasur për të mbështetur vlerësimin e riskut, për një targetim më të mirë dhe vendimmarrje më efektive në lidhje me dërgesat që duhen inspektuar;
 - b. Uljen e barrës administrative për ofruesit e të dhënave të anijeve, rritjen dhe lehtësimin e tregtisë dhe çlirimin më të shpejtë të mallrave si dhe përmirësimin e menaxhimit të riskut, sigurisë dhe mbledhjes së të ardhurave.

Neni 4

Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr përsipër detyrimet e mëposhtme:
 - a) Të sigurojë integrimin e sistemit ASYHUB në sistemin elektronik doganor Asycuda World;
 - b) Të sigurojë përmes ASYHUB ofrimin e të dhënave të dakordësuara, sipas Aneksit II, pjesë integrale e kësaj marrëveshje;

- c) Bazuar në informacionin paraprak të hyrjes apo daljes të ngarkesave detare të marra nga sistemi ASYHUB, të marrë masa për:
 - i. përzgjedhjen për kontroll të ngarkesave me risk, bazuar në rezultatet e analizave të riskut;
 - ii. dhënien prioritet çlirimit të ngarkesave me risk të ulët për mallrat që mbërrijnë në portin e hyrjes (përpunimi para mbërritjes) apo të daljes (përpunimi para nisjes);
- d) Të sigurojë trajnim për stafin e administratës doganore për të përdorur dhe mirëmbajtur sistemin.

Neni 5

Detyrimet e Autoritetit Portual

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, Autoriteti Portual merr përsipër detyrimet e mëposhtme:
 - a) Të integrojë sistemet IT portuale me platformën ASYHUB;
 - b) Të mundësojë depozitimin e të dhënave nga ofruesit e tyre (transportues dhe /ose përfaqësuesit e tyre ligjorë);
 - c) Të sigurojë përmes ASYHUB ofrimin e të dhënave doganore të dakordësuara, sipas Aneksit I, pjesë integrale e kësaj marrëveshje;
 - d) Të garantojë cilësinë, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të transmetuara;
 - e) Të sigurojë trajnim për stafin e Autoritetit Portual për të përdorur dhe mirëmbajtur sistemin.

Neni 6

Veprime të përbashkëta

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, Palët marrin përsipër detyrimet e mëposhtme të përbashkëta:
 - a) Të sigurojnë integrimin e sistemit ASYHUB me ekosistemin aktual lokal, të tillë që të sigurojnë një tranzicion dhe pranim të qetë nga të gjithë aktorët dhe përdoruesit përfundimtarë të përfshirë në zhdoganimin e ngarkesave detare;
 - b) Të shfrytëzojnë në mënyrë efektive informacionin e shkëmbyer nëpërmjet sistemit ASYHUB, në funksion të plotësimit të detyrimeve të tyre;
 - c) Të sigurojnë një menaxhim të koordinuar të riskut, përmes disponueshmërisë së informacionit të avancuar mbi ngarkesat e anijeve të siguruar përmes Sistemit ASYHUB;
 - d) Të rrisin bashkëpunimin midis dy palëve lidhur me zbatimin e standardeve të përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes, të masave të kontrollit dhe fushave prioritare të kontrollit;
 - e) Të informojnë palën tjetër për çdo ndryshim në legjislacionin e tyre specifik lidhur me këtë fushë veprimi.

Neni 7

Koordinimi mes palëve

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, të komunikimit dhe të koordinimit ndërmjet tyre në rast të hasjes së problematikave, palët caktojnë përfaqësues të tyre si pika kontakti.
2. Për çdo komunikim apo problematikë të konstatuar, pikat e kontaktit vënë në dijeni menjëherë eprorët e tyre:
3. Pikat e kontaktit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave do të jenë:
 - a) Përgjegjësi i turnit i sheshit të kontenierëve në Degën Doganore Durrës;
 - b) Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit dhe Analizës së Riskut, në Drejtorinë e Analizës së Riskut dhe Monitorimit;
 - c) Përgjegjësi i Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk), në Drejtorinë e Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse.
4. Pika e kontaktit për Autoritetin Portual do të jenë:
 - a) Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit të Teknologjisë së Informacionit
 - b) Përgjegjësi i Terminalit
 - c) Përgjegjësi i Turnit të Terminalit
5. Palët shkëmbejnë me shkresë ndërmjet tyre të dhënat e pikave të kontaktit, si dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 8

Konfidencialiteti

1. Palët marrin përsipër ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me çdo të dhënë apo informacion, me të cilat vihen në dijeni gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, duke marrë masat e nevojshme që mundësojnë sigurinë e të dhënave, në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Këto të dhëna apo informacione, nuk mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato që përfshihen ngushtësisht në ushtrimin e aktivitetit të secilës palë.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Palët angazhohen në këtë marrëveshje të respektojnë të gjitha dispozitat e ligjit nr.124, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të tyre të dala në zbatim të tij, gjatë dhe në përfundim të kontrollimit, shkëmbimit, përpunimit, administrimit apo marrjes dijeni të të dhënave të regjistruara në bazën e tyre elektronike.
2. Palët në referim të nenit 7 të ligjit nr. 124, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, angazhohen që të dhënat personale dhe informacionet që do të shkëmbehen në zbatim të kësaj marrëveshje, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera të ndryshme nga qëllimi i kësaj marrëveshje.

Neni 10
Afati dhe zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet me një afat të pacaktuar.
2. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshje, duke filluar nga data e nënshkrimit.
3. Kjo marrëveshje mund të shfuqizohet ose të ndryshojë me pëlqimin e palëve dhe çdo ndryshim do të jetë në përshtatje me legjislacionin në fuqi, me kusht që pala duhet të njoftojë me shkrim paraprakisht palën tjetër jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara.
4. Në rast moszbatimi të detyrimeve reciproke të pranuar në marrëveshje nga njëra palë, atëherë pala tjetër ka të drejtën të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes.

Neni 11
Dispozita Përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.
2. Në rast mosplotësimi të detyrimeve të mësipërme, secila palë duhet të informojë palën tjetër.
3. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim.
4. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse.
5. Secila nga Palët mund t'a zgjidhë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në çdo kohë, duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim 30 ditë para. Zgjidhja do të ketë efekt në ditën e 30-të nga data e njoftimit.

Nënshkruar në Durrës, më 22.10. 2025, në katër kopje autentike, nga dy për secilën palë.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE**

Genti GAZHELI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

AUTORITETI PORTUAL Durrës

Kreshnik BAJRAKTARI

DREJTOR EKZEKUTIV

ANEKSI 1 - Te dhenat qe Autoriteti Portual do ti dergoje DPD-se

TE DHENAT E MANIFESTIT

Te dhena	Kutite e DAV.	Emertimi i fushes	Manifesti
1.3	1.3	Deklarata e transitit/statusi mallrave	AXY
1.4	3	Formularet	
1.5	4	Lista e ngarkimeve	
1.6	32	Numri artikujve	AX
1.8	54	Nenshkrimi	AY
1.9	5	Numri total i artikujve	
2.1	40	Dek. Thjeshtuar/dok. Meparshem	AXY
2.2	44	Inf. Shtese	AX
2.3	44	Inf. Shtese	AX
2.4	7	Nr. references/UCR	XY
2.5		LRN	AY
3.1	2	Eksportuesi	
3.2	2	Nr. identif. Eksportuesit	
3.9	8	Marresi/Importuesi	AXY [12]
3.2	14 (n)	Identifikimi Perfaqsesit	AY
3.21	14	Kodi statusit perfaqsesit	AY
3.42		Nr. identif. Personit qe dorzon dekl. Dog. Mallrave	AY
3.43		Nr. identif. Personit qe kerkon proven e statusit mall	
5.4	50, 54	Data e deklarates	
5.5	50, 54	Vendi i deklarates	
5.22	30	Vendi i shkarkimit	AXY
5.28	44	Vlefsh. e kerkuar e deshmise per statusin e mallrave	AY
6.1	38	Pesha neto	
6.5	35	Pesha bruto	AXY
6.8	31	Pershkrimi i mallrave	AX [34]
6.9	31	Lloji paketimit	AX
6.10	31	Nr. pakove	AX
6.11	31	Shenjat e anijeve	AX
6.13	31	Kodi CUS	CX
6.14	33(1)	Kodi i mallrave	AX [37]
6.18	6	Pakot totale	
7.10	31	Nr. ident. Konteinerit	AXY
7.14	21(1)	Iden. Mjeteve aktive te trans.	AY

[12] Kodi RIOE

[34] Jepet si e dhene kur nuk eshte e dhene kodi i mallrave

[37] jepet kur transiti eshte bere nga i njejti person ne te njejten kohe ose kur parashikohet nga legjislacioni i RSH

A I detyrueshem: te dhënat e kërkuara nga autoriteti kompetent

B Fakultativ për autoritetin kompetent: të dhënat që autoriteti mund të vendosë për t'i hequr

C Fakultativ për operatorët ekonomikë: të dhënat të cilat operatorët ekonomikë mund të vendosin për t'i

dhënë, por që nuk mund të kërkojnë nga autoriteti kompetent.

X Elementi i të dhënave në nivel artikulli të deklaratës së mallrave. Informacioni i shënuar në nivel artikulli të mallrave është i vlefshëm vetëm për artikujt e mallrave në fjalë.

Y Elementi i të dhënave të kërkuara në nivelin kryesor të deklaratës së mallrave. Informacioni i shënuar në nivel kryesor është i vlefshëm për të gjithë artikujt e deklaruar të mallrave.

Çdo kombinim i simboleve "X" dhe "Y" nënkupton se elementi i të dhënave mund të jepet nga deklaruesi në secilin prej niveleve në fjalë.

ANEKSI II - Te dhenat qe DPD do ti dergoje Autoritetit Portual

TE DHENAT E DEKLARATES/TRANZITIT

Kutite e DAV	Kutite e Tranzitit	Emertimi i fushes
Nuk ka kuti deklarate, e dhene nga data base		Instance ID
nr.31	nr.31	Numri i kontejnerit
Kutia A	Kutia A	Kodi i zyres doganore
Kutia nr.47/nenndarja B	Kutia 9	Numri i pranimi per deklaratat e IMP/Numri i rregjistrimit per deklaratat e Tranzitit
Kutia nr.47/nenndarja B	Kutia 9	Datat e pranimi per deklaratat e IMP/Data e rregjistrimit per deklaratat e Tranzitit
Kutia 1 /nenndarja e pare dhe e dyte	Kutia 1/nenndarja e trete	Tipi i dokumentit Import ose Tranzit.